


INDEKSI I KUSHTIMIT NË NDËRTIM TREMUJORI I TRETË 2007



Në tremujorin e tretë të vitit 2007, Indeksi i Kushtimit në Ndërtim arriti 126.9 përqind (Trem.IV1999=100), duke shënuar një rritje 0.2 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Ndryshimi vjetor i Indeksit të Kushtimit në Ndërtim është 2.1 përqind. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1.8 përqind.

Indeksi i grupit “Shpenzime direkte” shënoi një rritje 0.4 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm. Brënda këtij grupi rritjen më të madhe e shënoi nëngrupi “Shpenzime materiale” prej 0.4 përqind. Këtu mund të përmendim rritjen e çmimeve të materialeve të ndërtimit prej 0.4 përqind, materialeve elektrike prej 1.3 përqind dhe materialeve hidro – sanitare prej 0.5 përqind.

Indeksi i grupit “Fitim i parashikuar” shënoi një ulje prej 1.1 përqind. Indeksi në nëngrupet e tjera varion nga + 0.1 në + 0.2 përqind.